

Laver Stroka

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Workers of all countries, unite!



16 Tetori

Dec. No. 7, 2006 Albania today & yesterday

Publisher: Dr.Laver Stroka <laverstroka@yahoo.com>

Buletini-7sh

Rreth 50 ish-pronarë, nga qyteti i Tiranës dhe rrethi i Kavajës do të jenë fatlumët e listës së gjatë prej 250 emrash që Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave do të vendosë të dëmshpërblejë financiarisht në fundjavë. Drejtoresha e Përgjithshme e kësaj agjencie, Justina Boriçi, ka deklaruar në një prononcim për shtyp se *shuma prej 3 milionë dollarësh, e akorduar nga qeveria për kompensimin financiar të ish-pronarëve të rrethit të Kavajës dhe qytetit të Tiranës, do të shpërndahet brenda datës 25 dhjetor*. Sipas saj, "në fund të javës do të jenë gati listat për t'u bërë të ditur pronarëve se kush përfiton nga fondi 3 milionë dollarë të akorduar nga qeveria". Sipas kriterëve të përcaktuara nga qeveria, kompensimi financiar do të bëhet maksimalisht për 200 metra katrorë dhe çmimi do të bazohet në hartën e vlerës së tokës për dy rrethet e përcaktuara. (Gazeta Shqip 19.12.2006)

Myslimanët që jetojnë në Evropë përballen me një diskriminim të dukshëm në arsim, punësim dhe fusha të tjera, çka ndikon negativisht në integrimin e tyre në shoqëri. ... Ky është përfundimi i një studimi të ndërmarrë nga Qendra Evropiane e Monitorimit të Racizmit dhe Ksenofobisë dhe bëhet fjalë për studimin e parë gjithëpërfshirës në lidhje me gjithë myslimanët që jetojnë në vendet e Bashkimit Evropian. Studimi titullohet: "Myslimanët në Bashkimin Evropian- Diskriminimi dhe Ksenofobia" dhe është një material 115-faqësh i shoqëruar nga një suplement në të cilin pasqyrohen shumë intervista myslimanësh ..*Bashkimi Evropian ka 15 milionë myslimanë dhe feja islame renditet e dyta në kontinent pas asaj të krishterë*. ...veçanërisht brezi i ri po përballlet me shumë barriera shoqërore çka e bën jetesën e tyre në venet evropiane të vështirë, duke ndezur ndjenjat e përjashtimit dhe të mungesës së shpresës. "Islamofobia" është një tendencë që është rritur sidomos pas sulmeve terroriste dhe vitet e fundit ajo u ndërthur me ndjenjat që ekzistonin prej kohe të ksenofobisë dhe diskriminimit racial. Sipas të dhënave nga vende të ndryshme, popullsia myslimane rezulton të jetë vendosur në zonat më të papërshtatshme të banimit, ndërkohë që për sa i përket arsimit, ai është shumë problematik, madje po aq sa punësimi ... (Gazeta Shqip 19.12.2006)

Prishtinë, gaz lotsjellës kundër protestuesve

Albin Kurti: Institucionet aktuale nuk paraqesin vullnetin tonë

Protesta e lëvizjes "Vetëvendosja" ka tejkaluar çdo parashikim. Shumëkush kishte menduar se demonstrata e paralajmëruar prej disa ditësh do të ishte një dështim, por jo. Mijëra njerëz nga e gjithë Kosova duket se e kanë kuptuar mirë mesazhin e Albin Kurtit dhe të të rinjve të tjerë të "Vetëvendosjes". Rreth orës 14:00, turma ka nisur marshimin në rrugët e Prishtinës. E para ka qenë ndërtesa e qeverisë që është "gjakosur".

"Gjak" mbi institucione

Shishe të mbushura me bojë të kuqe janë derdhur mbi xhamat e ndërtesës më të lartë të Prishtinës, qeverisë. "Këto institucione nuk e paraqesin vullnetin tonë, e vullneti ynë nuk është të negociohet me Serbinë e këto institucione nuk na i mbrojnë interesat e as decentralizimi e eksterritorialitete" iu drejtua turmës lideri i lëvizjes "Vetëvendosja", Albin Kurti, duke i ftuar demonstruesit të gjuajnë me shishe boje institucionet. Të rinjtë e "Vetëvendosjes" kanë krijuar gardhe të gjalla. Të kapur dorë për dore, ata janë përpjekur të ndalin turmën, e cila ka përdorur edhe gurë, për të goditur xhamat. Pasi janë thyer disa xhama dhe bërë me bojë të kuqe, radhën e ka pasur qeveria dhe Parlamenti. Parullat e vetëvendosjes dhe të UÇK-së janë dëgjuar shpesh. Në turmë kishte edhe politikanë, por numri i tyre ishte i vogël. Mbështetësit kishin ardhur nga të gjitha komunat.

Pakënaqësitë në rritje

Pakënaqësitë janë rritur në masë të madhe te qytetarët e Kosovës, veçanërisht pas shtyrjes së statusit. Selman Hoxha është një mjek nga Podujeva. "Duam liri tha ai, vetëvendosje, pasi ne nuk e kemi krijuar vetveten; këtu në Kosovë, ne kemi lindur këtu dhe kjo që po kërkojmë është e drejta themelore". Premtimet e politikës duket se i kanë zhgënjyer njerëzit. "Kam pritur që festën e Flamurit ta festoj me Kosovën e pavarur", thotë Xhemajl Islami, një 60-vjeçar nga Prishtina. Janë të shumtë që mendojnë si ai.

Gaz lotsjellës kundër turmës

Pas shisheve me bojë dhe gurëve, disa protestues u ngjitën mbi mburojat e larta të betonit dhe i tërhoqën me litarë. Policët ndërkombëtarë në këtë moment kanë hedhur gaz lotsjellës për të shpërndarë turmën. Të rinj, pleq, gra dhe fëmijë janë gjendur papritur në tymin e gazit dhe kanë filluar të largohen me shpejtësi. Sirena e ambulancave është dëgjuar menjëherë për të dhënë ndihmën e parë. Policia nuk arrestoi asnjë person dhe pas më shumë së një ore protestuesit u shpërndanë në shtëpitë e tyre. Policia gjatë gjithë kohës qëndroi larg protestuesve. Këta të fundit nuk kishin marrë leje qëllimisht për të nxitur reagimin e tyre. Por këtë herë policët nuk përdorën prangat dhe forcën për t'i ndaluar. KFOR ka qëndruar në distancë, por trupat e tij kanë qenë në gjendje gatishmërie.

Indiferentët

Disa ende i besojnë klasës politike dhe i justifikojnë për shtyrjen e statusit. Kjo është arsyeja sepse kanë qëndruar indiferentë ndaj protestës. Të rinj që kishin dalë për të festuar, nuk iu bashkëngjitën protestës. Ata vazhdonin jetën e tyre normale. Disa lokale ishin plot më njerëz, të cilët pinin kafe. Ndërsa banorët e Prishtinës mund t'i shihje edhe nëpër ballkonet e tyre duke shikuar protestën. Ndërsa paraditja në kryeqytetin e Kosovës ka qenë tërësisht e kuqe. Flamuj nëpër rrugë, lokale, dyqane. Flamuj që shiteshin, tollombace në duar të fëmijëve. Dhe një autobus që për të bërë reklamën e duhanit ka gjetur mënyrën më të mirë. Ka shkruar mbi vete fjalën "Sovereign", që do të thotë pavarësi. (Gazeta shqip 29.11.2006)